



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

**NJOFTIM PËR RENDIN E DITËS**

Mbledhje Jashtë Radhe

Me Mjete Të Komunikimit Elektronik

Në mbështetje të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 50, të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19“, neni 5 “Vendimmarrja nga Organet Kolegjiale,, Këshilli Bashkiak Durrës,

**NJOFTON:**

DITËN E PREMTE, DATË 26.03.2021, ORA 12:00, KËSHILLI DO TË MBAJË NJË MBLEDHJE JASHTË RADHE, ME KËRKESË TË ZËVENDËSKRYETARES, QË KRYEN FUNKSIONET E KRYETARIT TË BASHKISË, NËPËRMJET MJETEVE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK, ME KËTË REND DITE:

****	<b>MIRATIMI I RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES</b>
1. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	<b>MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR.55, DATË 26.06.2020, PËRSA I PËRKET LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUAR SI PASOJË E DËMEVE SHKAKTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË</b> <b>DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR.</b>
2. Relatim dhe miratim i	<b>PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1032 RRUGA "ALEKS</b>

projekt-vendimit të Komisionit KB	<b>KOMNENI" DHE PALLATIN "KASTRATI" RRUGA"RAMADANVELIU" TËDËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.</b>
<b>3.</b> Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	<b>PËR VIJIMIN E PROCEDURËS TË PRISHJES SË DETYRUAR TË NJË OBJEKTI BANIMI, PRONË PRIVATE (PALLAT), TË NDODHUR NË NJESINË ADMINISTRATIVE NR.5 , DURRËS, NË ZBATIM TË EKSPERTIZËS SË THELLUARA TË HARTUARA NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË</b>

Komisionet, që do të shqyrtojnë projektvendimet dhe relacionet do të jenë:

Në mbështetje të nenit 5 të Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020, të nenit 33, neni 34/1, neni 77 /8 të Rregullores së Funkionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, anëtarët e Komisionit të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin elektronikisht relacionin përkatës, dërgojnë me email ([rroshialneida@yahoo.com](mailto:rroshialneida@yahoo.com)) propozimin e tyre (RAPORTIN) mbi relacionin sipas grafikut të mëposhtëm.

Pika 1, 2, do të shqyrtohet nga:

- Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike
- Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike  
dhe do të sjellin me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **20.00**.

Pika 3, do të shqyrtohet nga:

- Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike  
Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokë  
Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike

dhe do të sjellin me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **20.00**.

**ALNEIDA RROSHI**

**KRYETARE E KOMISIONIT TË RREGULLORES, ÇËSHTJEVE JURIDIKE**